



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Rruga "Abdi Toptani" ish- hotel "Drini", Tiranë

Tel. 04 22 68141; 04 22 68142

Nr. 295/3 Prot.

Tiranë, më 13.06.2017

V E N D I M
Nr. 133, datë 13.06.2017

*"Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së punonjësës
*****, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 295 prot., datë 21.04.2017"*

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1 dhe nenet 14 e 15, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i RSH", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Mbikëqyrjes, në përfundim të procedurës së verifikimit,

VËREJ SE :

Me anë të një letre, protokolluar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil punonjësja ***** , ka ngritur pretendimin se transferimi i përkohshëm i saj, për një periudhë 6 muaj, nga pozicioni "Drejtor" në Drejtorinë e Punëve Publike, pranë Bashkisë Pogradec, në pozicionin "Specialist për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës", në Njesisë Administrative Trebinjë, pranë Bashkisë Pogradec, është kryer në kundërshtim me kërkesat e ligjit për shërbimin civil, pasi ky transferim nuk është realizuar në një pozicion pune të së njëjtës kategori.

Për këtë arsye, nëpunësja në fjalë e ka konsideruar aktin për transferimin e saj si veprim administrativ të nxjerrë në kundërshtim me ligjin për shërbimin civil dhe për këtë shkak, ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për të mbikëqyrur zbatimin e ligji nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe aktet nënligjore dalë në bazë dhe për zbatim të tij, në drejtim të aplikimit të institutit të transferimit.

Nga këqyrja e akteve në institucion si dhe nga analiza e dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, rezulton se nëpunësja ***** , është bërë pjesë e shërbimit civil, pasi ka dalë fituese në procesin e konkurrimit, ku është përfshirë si kandidat e jashtme në procedurën e ngritjes në detyrë, të shpallur me aktin nr. 201, datë 23.12.2014, nga Bashkia Pogradec, për

pozicionin vakant, “*Drejtor*” i Drejtorisë së Punëve Publike. Ky konkurrim ishte shpallur i hapur edhe për kandidatë nga jashtë shërbimit civil, me vendim të Kryetarit të Bashkisë, në përputhje me rregullimet e ligjit për nëpunësin civil.

Në përfundim të procesit të konkurrencës, nëpunësja në fjalë, me aktin nr. 15, datë 23.02.2015, të Kryetarit të Bashkisë, është shpallur fituese dhe është emëruar në pozicionin e punës “*Drejtor*”, pranë Drejtorisë së Punëve Publike, bazuar në pikët e marra nga Komisioni vlerësues, i ngritur me urdhrin nr. 81, datë 26.12.2014.

Më tej, me kërkesën e saj, protokolluar me nr. 67, datë 19.05.2016, drejtuar titullarit dhe njësisë së burimeve njerëzore të Bashkisë Pogradec, kjo punonjëse ka kërkuar pezullimin e statusit të nëpunësit civil, për arsye të ndjekjes së studimeve për një periudhë 2 vjeçare, duke kërkuar që pezullimi të fillojë në datën 04.06.2016.

Si rregull, njësia përgjegjëse (*NJBNI*) e institucionit, bazuar në pikën 13, të Vendimit nr. 124, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil*”, duhet të shqyrtoj kërkesën për pezullim brenda 10 ditëve nga paraqitja e saj. Mbas kalimit të këtij afati ligjor, njësia përgjegjëse nuk i ka kthyer përgjigje nëpunëses, e për pasojë ajo është paraqitur rregullisht në punë duke hequr dorë nga studimet.

Pas kësaj, konstatohet se, pavarësisht faktit të përfundimit të afatit ligjor të shqyrtimit të kërkesës për pezullim nga ana e njësisë përgjegjëse, në kushtet kur nëpunësja në vijim, nuk kishte treguar interes për t’u pezulluar, institucioni e ka vlerësuar si aktive kërkesën për pezullim dhe me aktin nr. 544, datë 02.11.2016, pra 4 muaj më vonë, e ka miratuar atë.

Kundër këtij veprimi administrativ të njësisë përgjegjëse të Bashkisë Pogradec, nëpunësja në fjalë ka paraqitur padi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

Në përfundim të shqyrtimit të këtij rasti, gjykata ka vendosur të rikthej në detyrën që kishte punonjësen ***** dhe pagimin e pagës së saj nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare, që fillonte në datën 07.11.2016, deri në datën e rikthimit në punë.

Rezulton se vendimi i gjykatës nuk është apeluar nga institucioni, e për këtë arsye, ai ka marrë formë të prerë. Në ekzekutim të këtij vendimi, rezulton se me aktin nr. 100, datë 15.03.2017, të njësisë përgjegjëse dhe Kryetarit të Bashkisë Pogradec, është vendosur rikthimi i nëpunëses në pozicionin që kishte “*Drejtor*”, pranë Drejtorisë së Punëve Publike.

Ndërkohë, konstatohet se nga ana e Koordinatorit të Njësive Administrative dhe Zhvillimit Rural, me shkresën nr. 101 prot., datë 10.04.2017, “*Kërkesë për bashkëpunim*”, drejtuar Kryetarit të Bashkisë dhe për dijeni njësisë përgjegjëse, është kërkuar transferim, ose emërim i një punonjësi, për kryerjen e detyrave në pozicionin e punës “*Specialist për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës*”, në Njësinë Administrative Trebinjë, për nevoja emergjente të funksionimit dhe organizimit të Departamentit që ai drejton, pasi në këtë njësi nuk ka asnjë punonjës që të realizojë këtë funksion.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, njësia përgjegjëse e institucionit, me shkresën nr. 101/1, datë 10.04.2017, drejtuar Kabinetit dhe nënkryetarëve të Bashkisë, ka raportuar tek këta të fundit,

problematikën e paraqitur nga Koordinatori i Njësive Administrative, duke propozuar si zgjidhje për këtë rast, transferimin e përkohshëm të një punonjësi me eksperiencë për një periudhë prej 6 muajsh, e njëkohësisht i ka kërkuar gjithashtu të propozojnë një punonjës nga bashkia, për tu transferuar në pozicionin që ka mbetur vakant.

Sipas korrespondencës në vijim, me shkresën nr. 101/2, datë 10.01.2017, Kabineti i Kryetarit ka propozuar për të transferuar përkohësisht në pozicionin “*Specialist për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës*”, në Njësine Administrative Trebinjë, punonjësen *****, e punësuar në pozicionin “Drejtor i Punëve Publike”, me argumentin se, sektori që ajo drejton, mund të funksionojë përkohësisht, edhe në mungesë të saj.

Në bazë të propozimit më sipër, me aktin administrativ nr. 205, datë 28.04.2017, të njësive përgjegjëse dhe Kryetarit të Bashkisë Pogradec, është vendosur transferimi i përkohshëm i punonjëses *****, nga pozicioni i punës “Drejtor”, në Drejtorinë e Punëve Publike, pranë Bashkisë Pogradec, në pozicionin e punës, “*Specialist për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës*”, në Njësine Administrative Trebinjë, pranë Bashkisë Pogradec.

Ky veprim administrativ është edhe objekti i mosmarrëveshjes që ka lindur midis nëpunëses dhe institucionit, në lidhje me mos respektimin e kërkesave gjatë një procedure transferimi, për të cilin Komisioneri ka vendosur që të kryejë një hetim administrativ.

Nga analiza e kërkesës që punonjësja i ka drejtuar Komisionerit, evidentohet pretendimi se transferimi i saj nuk është kryer në të njëjtën kategori, ashtu si e kërkon ligji, duke e argumentuarat me faktin se ajo është transferuar nga një pozicion i kategorisë të nivelit të mesëm drejtues, në një pozicion më të ulët, që i përket kategorisë ekzekutive.

Nisur nga përmbajtja e akteve shkresore që materializojnë këtë proces, të administruara gjatë verifikimit të rrethanave të çështjes, rezulton se pretendimi i ankueses është i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore që rregullojnë institutin e transferimit në shërbimin civil.

Në pikën 1, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe pikën 2, Kreu I, të Vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”, përcaktohet se, “*nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori....”.*

Ky përcaktim do të thotë se akti administrativ për transferimin e përkohshëm të punonjësës *****, në një kategori më të ulët se statusi që ajo gëzon në shërbimin civil, është në kundërshtim të hapur me dispozitat e cituara më sipër.

Për më tepër, në rastin e punonjësës në fjalë, është lejuar dhe një shkelje tjetër ligjore, në kushtet kur, njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe titullari i institucionit, gjatë procesit të vendimmarrjes për transferimin e nëpunëses, nuk kanë marrë parasysh faktin se ajo nuk është e përshtatshme në pozicionin ku u transferua, pasi nuk i plotëson kriteret e pozicionit të punës.

Në këtë përfundim arrihet për faktin se, për të punuar në pozicionin “*Specialist për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës*”, nevojitet që punonjësi të zotërojë një diplomë në shkencat e gjeodezisë, ose agronomisë, sipas profileve të miratuara në përshkrimin e punës nga institucioni (*Agronomi, Agromjedis, Ekologji, Inxhinieri Pyjore, Hortikulturë e Mbrojtje Bimësh,*

Politika Agrare). Në rastin që po shqyrtojmë, rezulton se nëpunësja zotëron një diplomë në degën “*Inxhinieri Ndërtimi*”, ç’ka do të thotë se ajo nuk i ka njohurit e duhura për të realizuar detyrat e pozicionit ku është e transferuar.

Më tej, në përcaktimet e pikës 5, të Kreut I, të Vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”, ligjvënësi ka përcaktuar mes të tjerash se, “*Për marrjen e vendimit të transferimit të përkohshëm në interes të institucionit, sipas shkronjës “a”, të pikës 2, të këtij vendimi, njësia përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësimit nga ana e nëpunësit, të kriterëve të pozicionit të punës ku ai kërkohet të transferohet, si dhe në plotësimin e kushteve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar...)*).

Ndërkohë, konstatohet se këto përcaktime nuk janë marrë parasysh nga Kryetari dhe njësia përgjegjëse e Bashkisë Pogradec, gjatë marrjes së vendimit nr. 205, datë 28.04.2017, për transferimin e përkohshëm të nëpunëses *****.

Nisur nga gjithë s’analizuam më sipër, Komisioneri vlerëson se vendimi objekt shqyrtimi, për transferimin e përkohshëm, për një periudhë 6 mujore, të punonjësës ***** , nga pozicioni i punës “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Punëve Publike, pranë Bashkisë Pogradec, në pozicionin “*Specialist për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës*”, në Njësisë Administrative Trebinjë, pranë Bashkisë Pogradec, është marrë në kundërshtim me pikën 1, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe pikën 2 e 5, të Kreut I, të Vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”.

Në këto rrethana, bazuar në nenin 109, germa “*d*”, të ligjit 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të RSH*”, vendimi nr. 205, datë 28.04.2017, i Kryetarit të Bashkisë Pogradec, për transferimin e përkohshëm të nëpunëses, është një akt administrativ i paligjshëm, për arsye se vjen në kundërshtim me ligjin material.

Për të rregulluar ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil në këtë rast, Kryetari dhe njësia përgjegjëse e Bashkisë Pogradec, bazuar në pikën 1, të nenit 113, të Kodit të Procedurës Administrative, duhet të shfuqizojnë menjëherë aktin administrativ nr. 205, datë 28.04.2017, të Kryetarit dhe njësisë përgjegjëse të Bashkisë Pogradec, për transferimin e përkohshëm për një periudhë 6 mujore të punonjësës ***** , nga pozicioni “*Drejtor*” në Drejtorinë e Punëve Publike, pranë Bashkisë Pogradec, në pozicionin “*Specialist për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës*”, në Njësisë Administrative Trebinjë, pranë Bashkisë Pogradec dhe nëpunësja duhet të rikthehet në pozicionin e saj të mëparshëm të punës.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” e nenin 35, të Rregullores, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Kryetari i Bashkisë Pogradec dhe njësia përgjegjëse, pranë Bashkisë Pogradec, të shfuqizojnë aktin administrativ nr. 205, datë 28.04.2017, për transferimin e përkohshëm për një periudhë 6 mujore të punonjës ***** , nga pozicioni “Drejtor” në Drejtorinë e Punëve Publike, pranë Bashkisë Pogradec, në pozicionin “Specialist për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës”, në Njesisë Administrative Trebinjë, pranë Bashkisë Pogradec, si akt i nxjerrë në kundërshtim me ligjin.
2. Të rregullohen pasojat e krijuara nga ky akt administrativ, në dëm të nëpunëses civile duke e rikthyer atë në pozicionin e saj të mëparshëm të punës.
3. Të njoftohen për këtë vendim, Kryetari i Bashkisë Pogradec dhe njësia përgjegjëse e institucionit, si dhe nëpunësja *****.
4. Për kryerjen e detyrave të përcaktuara më sipër, institucionit i lihet afat, **15 ditë**.
5. Me kalimin e këtij afati, duhet të njoftohet me shkrim Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mënyrën e zbatimit të vendimit.
6. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA